FLETUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

HYDROCUTAN

Pomadë – 1%
(Hidrokortizon)

Lexoni me kujdes këtë fletudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletudhëzues. Mund t'ju nevojitet ta lexoni përsëri.
- Drejtohuni tek mjeku ose farmacisti juaj nëse kërkoni këshilla ose informacion të mëtejshëm.
- Ky bar është përshkruar për ju personalisht. Mos ja jepni atë personave të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe nëse kanë simptoma të njëjta si ju.
- Nëse ndonjë prej efekteve anësore të përmendur ju shqetëson, ose nëse vini re efekte anësore të cilët nuk janë të përmendur në këtë fletudhëzues, ju lutemi të informoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletudhëzues:

1. Çfarë është Hydrocutan dhe përse përdoret?
2. Çfarë duhet të dini përpara se të përdorni Hydrocutan?
3. Si ta përdorni Hydrocutan?
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Hydrocutan?
6. Informacione të mëtejshme

1. ÇFARË ËSHTË HYDROCUTAN DHE PËRSE PËRDORET?
Pomada 1% Hydrocutan përmban lëndën aktive hidrokortizon, i cili është një glukokortikoid.
Ajo përdoret për trajtimin e sëmundjeve inflamatore të lëkurës, në të cilat indikohet përdorimi topik i glukokortikoidëve të dobët.

2. ÇFARË DUHET TË DINI PËRPARA SE TË PËRDORNI HYDROCUTAN?
Hydrocutan nuk duhet të përdoret në:
mbindjeshmëri ndaj njërit prej përbërësve, infeksione nga herpes simpleks, sëmundjen e lisë, reaksione nga vaksinimi, procese specifike në lëkurë (p.sh. sifiliz, tuberkuloz), mykoza, procese bakteriale në lëkurë, rozace dhe dermatit perioral.
Hydrocutan nuk duhet të përdoret në sy ose përreth tij, në membrana mukoze si dhe në sëmundje që lidhen me çrregullime të aksit hipotalamus – hipofizë (p.sh. sindroma Cushing).

Tregoni kujdes të veçantë gjatë përdorimit të Hydrocutan:
Flisni me mjekun ose farmacistin përpara se të përdorni Hydrocutan.
Hydrocutan mund të përdoret në fytyrë vetëm me një kujdes të posaçëm.
Në rast trajtimi në zonën gjenitale ose anale, nëse përdoren njëkohësisht prezervativë lateksi, eksipientët parafinë dhe vaj parafine mund të reduktojnë rezistencën gjatë tërheqjes dhe në këtë mënyrë të kompromet ojnë sigurinë e tyre.
Nëse ju shfaqet shikim i turbullt ose shqetësime të tjera të shikimit, kontaktoni mjekun.

Gjatë përdorimit të Hydrocutan pomadë 1 % me barna të tjera:
Ju lutemi të informoni mjekun ose farmacistin tuaj nëse merrni / përdorni barna të tjera, i keni marrë / përdorur para pak kohësh ose planifikoni të merrni / përdorni barna të tjera, edhe nëse bëhet fjalë për barna të marra pa recetë.
Nëse përdorimi bëhet sipas mënyrës së përshkruar, nuk pritet përthithje sistemike e steroidit.
Nëse ndodh përthithja sistemike, mund të priten efektet e mëposhtme:
- glikozidet kardiake: efekti i glikozideve theksohet nga mungesa e kaliumit
- saluretikët: eliminim i shtuar i kaliumit
- antidiabetikët: reduktohet ulja e sheqerit në gjak
- derivatet e kumarinës: efekti antikoagulant dobësohet
- rifampicina, fenitoina, barbituratet: efekti kortikoid dobësohet
- antiinflamatorët / antireumatikët josteroidë: rritet rreziku i gjakrrjedhjes gastrointestinale.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji
Nëse jeni shtatzënë ose ushqeni me gji, mendoni se mund të jeni shtatzënë ose planifikoni një shtatzëni, këshillohuni me mjekun ose farmacistin përpara se të përdorni këtë bar.

Shtatzënia
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përdorimin e pomadës 1% të hidrokortizonit tek gratë shtatzëna. Në studimet në kafshë glukokortikoidët kanë treguar efekte të dëmshme për pasardhësin. Edhe për fetusin e njeriut diskutohet një risk i rritur për deformim të qiellzës nëse glukokortikoidët përdoren në tremujorin e parë të shtatzënisë. Studimet në kafshë gjithashtu kanë treguar se dhënia e glukokortikoidëve në doza terapeutike gjatë shtatzënisë vonon rritjen e pasardhësit si dhe mund të shkaktojë shfaqjen e sëmundjeve kardiovaskulare dhe / ose sëmundjeve të metabolizmit në moshë të rritur, si dhe çrregullime afatgjata të sjelljes. Nëse jeni shtatzënë, mund ta përdorni Hydrocutan vetëm nëse mjeku juaj e konsideron të domosdoshme. Ju lutemi të kontaktoni menjëherë mjekun.

Ushqyerja me gji
Lënda aktive e kësaj pomade kalon në qumështin e gjirit. Nëse e përdorni këtë bar në sipërfaqe të madhe ose për një kohë të gjatë, duhet ta ndërprisni ushqyerjen me gji. Duhet të shmanget kontakti i foshnjes me pjesët e sëmura të lëkurës. Nënat që ushqejnë me gji nuk duhet të aplikojnë hidrokortizon në zonën e gjirit.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Nuk është e nevojshme të merren masa të veçanta.

Informacione të rëndësishme për disa nga përbërësit e Hydrocutan:
Alkooli stearilik mund të shkaktojë irritime lokale në lëkurë (p.sh. dermatit kontakti).

3. SI TA PËRDORNI HYDROCUTAN?
Gjithmonë përdoreni pomadën 1% Hydrocutan sipas udhëzimit të mjekut. Ju lutemi të këshilloheni me mjekun ose farmacistin tuaj nëse nuk jeni i sigurt.

Nëse nuk përshkruhet ndryshe nga mjeku, doza e zakonshme është:
Në fillim të trajtimit, pomada aplikohet 2 – 3 herë në ditë në shtresë të hollë në zonën e sëmurë të lëkurës dhe masazhohet. Lëkura nuk duhet të dëmtohet me fërkim të fortë ose duke ushtruar shumë presion. Përpara aplikimit, lëkura duhet të pastrohet me kujdes për të parandaluar infeksionet. Pasi shfaqet përmirësimi, aplikimi i pomadës bëhet më rrallë. Zakonisht, bëhet i mjaftueshëm një përdorim ditor në intervale 2 – 3 ditore.

Mënyra e përdorimit
Për përdorim në lëkurë.

Kohëzgjatja e përdorimit
Mjeku do të vendosë për kohëzgjatjen e trajtimit. Ajo do të varet nga lloji, graviteti dhe ecuria e sëmundjes.

Ju lutemi, flisni me mjekun ose farmacistin nëse keni përshtypjen se efekti i Hydrocutan është shumë i fortë ose shumë i dobët.

Nëse keni përdorur një sasi më të madhe Hydrocutan sesa duhet:
Reduktoni dozën, ose nëse është e mundur, ndërpriteni barin pas përdorimit në doza të larta dhe për një kohë të gjatë (më shumë se katër javë).
Gjatë përdorimit të zgjatur (më shumë se katër javë) dhe në sipërfaqe të madhe (më shumë se 1/10 e sipërfaqes trupore), veçanërisht nën veshje okluzive ose në lëkurë shumë të dëmtuar, lënda aktive mund të përthithet në trup dhe të shkaktojë efekte anësore, si p.sh. frenim i gjendrës mbiveshkore ose sindromë Cushing (obezitet trunkal, facies lunata). Në këtë rast këshillohuni me mjekun.

Nëse keni harruar të përdorni Hydrocutan:
Vazhdoni trajtimin sipas mënyrës së përshkruar.

Nëse ndërprisni përdorimin e Hydrocutan:
Sëmundja mund t'ju përkeqësohet.
Nëse keni pyetje të tjera për përdorimin e këtij bari, drejtohuni tek mjeku ose farmacisti juaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME
Si të gjitha barnat, Hydrocutan mund të ketë efekte anësore, por që mund të mos shfaqen tek kushdo.

Efekte të padëshiruara të mundshme
Në trajtimin për kohë të gjatë mund të shfaqen këto efekte anësore lokale: atrofi e lëkurës, teleangiektazi, strie, akne, dermatit perioral, infeksione sekondare.
Në përdorimin afatgjatë, në doza të larta ose në sipërfaqe të mëdha, mund të ndodhin efekte sistemike.
Nëse përdoret nën veshje okluzive mund të shfaqen: miliaria, hipopigmentim, macerim i lëkurës, folikulit, tharje e lëkurës, djegie, kruarje, irritime të lëkurës, favorizim i infeksioneve sekondare. Shërimi i plagëve vonohet.
Veçanërisht tek fëmijët dhe foshnjet duhet të tregohet shumë kujdes.
Të pazakonta (1 deri në 10 përdorues ndër 1,000): reaksione alergjike në lëkurë.
Të panjohura (shpeshtësia nuk mund të përcaktohet nga të dhënat që disponohen): shikim i turbullt.
Parashikohen edhe efekte anësore të përgjithshme si rezultat i përthithjes së lëndës aktive në trup, si p.sh. reduktim i funksionit të gjendrave mbiveshkore, simptoma të sindromës Cushing dhe rritje e presionit intraokular.
Gjatë përdorimit të zgjatur, me doza të larta të hidrokortizonit në lëkurë, kryesisht nën veshje okluzive (p.sh. zona e pelenave), mund të përthithet një sasi e tillë e lëndës aktive në trup sa të frenojë prodhimin që vetë trupi bën të ACTH; kjo mund të çojë në një rënie të nivelit të kortizolit në gjak. Mundësia e efekteve anësore të përgjithshme duhet të mbahet parasysh veçanërisht tek fëmijët.
Nëse shfaqen efekte anësore, trajtimi duhet të ndërpritet dhe të merren masat e nevojshme përkatëse.
Nëse ndonjë prej efekteve anësore të përmendura ju shqetëson ose nëse vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletudhëzues, informoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI HYDROCUTAN?
Ruajeni barin larg fëmijëve!
Ruajeni nën 25 °C.
Nuk duhet ta përdorni barin pas datës së skadencës të shënuar në paketim.

6. INFORMACIONE TË MËTEJSHME
Çfarë përmban Hydrocutan – Pomadë 1%:
Lënda aktive është hidrokortizoni.
1 g pomadë përmban 10 mg hidrokortizon.
Lëndët ndihmëse janë: parafinë e bardhë, vaj parafine, alkool stearilik, sorbitan seskuioleat, polisorbat, EDTA dinatriumi, ujë i pastruar.

Përmbajtja e paketimit:
Kuti me një tubet 30 g.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Janar 2024.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.